

Procedurat e vizave

Të gjithë të huajt që kanë një vizë të vlefshme Shengen me shumë-hyrje, tipi "C" ose "D", ose një leje qëndrimi në një nga shtetet anëtare të Shengenit, mund të hyjnë, të qëndrojnë dhe tranzit në Shqipri pa vizë, brenda afatit të vlefshmërisë së vizës apo lejes së qëndrimit.

Për qytetarët që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë pa viza, leja e qëndrimit është 90 ditë brenda një periudhe prej 180 ditësh dhe gjatë 30 ditëve të para të qëndrimit të tyre, ata duhet të paraqiten në Drejtorinë e Përgjithshme Kufiritare të Migracionit që të japin informatat e përgjithshme të tyre dhe kohën e qëndrimit përndryshe ata do të gjobiten kur ata largohen nga Shqipëria.

Të gjitha të huajt e tjerë duhet të pajisen me vizë nga një nga misionet e Republikës së Shqipërisë që mbulojnë vendin e tyre të banimit., para se të hyjnë në Republikën e Shqipërisë. Gjithashtu, këto misione mund t'ju japin atyre informacionet e nevojshme rreth Shqipërisë.

Për më shumë informacion mbi kriteret, procedurat dhe dokumentacionin për dhënien e vizave, ju lutem vizitoni faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, www.mfa.gov.al.

Rregullat doganore

Të gjitha sendet personale, të reja apo të vjetra mund të merren në Shqipëri pa asnjë veprim doganor. Gjithashtu, lejohen sasi e arsyeshme duhani, pijesh dhe parfumi për përdorim personal. Sendet e ndaluara përfshijnë armët, municionet, lëndët narkotike, barnat dhe mallrat të cilat rrezikojnë respektimin e rendit publik dhe sigurisë sociale. Për eksportimin e metaleve të çmuar, monedhave të lashta, sendeve antike, librave dhe veprave të artit, të cilat konsiderohen të jenë pjesë e kulturës kombëtare dhe trashëgimisë, duhet të merren leje të veçanta.

Për më shumë informacion mbi procedurat doganore, ju lutem vizitoni faqen zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, www.dogana.gov.al.